

Nr Prot. 00602/25Datë: 05.06.2025

Duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Shtimes dhe Flutura Academy të datës 13.05.2025, nr. 02/540, bëjmë:

THIRRJE PUBLIKE PËR REGJISTRIMIN E 60 NXËNËSVE PËR TRAJNIM NGA “FLUTURA ACADEMY”

Hapet Thirrja Publike për regjistrimin e 60 nxënësve të interesuar nga Komuna e Shtimes për trajnimin e grupeve të reja nga “Flutura Academy” për Programim për Fëmijë, Programim Bazik, Programim i Avancuar, Dizajn Grafik Bazik, Dizajn Grafik i Avancuar, Gjuhë Angleze dhe Gjuhë Gjermane.

Regjistrimet janë të hapura për programet:

- Programim për Fëmijë (8-10 vjeç),
- Programim Bazik (11-14 vjeç),
- Programim i Avancuar (15-18 vjeç),
- Dizajn Grafik Bazik (12-14 vjeç),
- Dizajn Grafik i Avancuar (15-18 vjeç),
- Gjuhë Angleze (8-18 vjeç) dhe
- Gjuhë Gjermane (11-18 vjeç).

Periudha e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është 9 muaj.

Kriteret e regjistrimit të nxënësve në Flutura Academy në Komunën e Shtimes

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 8-18 vjeç;
- Të jetë nxënës i regjistruar në njërin nga shkollat publike në Komunën e Shtimes ku operon “Flutura Academy”;
- Të ketë rezultate të mira mësimi në shkollë, përzgjedhja apo renditja bëhet sipas notës mesatare nga viti shkollor paraprak;
- Të ketë sjellje shembullore;
- Të pranojë dhe respektojë rregulloren e “Flutura Academy” për nxënësit;
- T’i referohet thirrjes publike (referuar konkursit të shpallur për regjistrimin e nxënësve nga Flutura Academy).

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Certifikata e notave (dëftesa kopje nga viti shkollor paraprak, apo librezë e notave kopje - përfshirë pjesët që përmbajnë të dhënat identifikuese të nxënësit dhe notat e vitit paraprak shkollor)
- Certifikata e lindjes (Ekstrakti i lindjes, mund të nxirret online)

Afati për aplikim është nga 05 - 25 qershor 2025.

Të gjithë të interesuarit për më shumë informata le të lajmërohen në Qendrën e Flutura Academy në Shtime (adresa: rruga "Tahir Sinani", ngjitur me objektin Institucionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Shtime), ku do të gjeni informacione të plota mbi programet e ofruara.

Rina Shabani – Koordinatore Ekzekutive

